



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBETARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Gjeografi e thelluar

Varianti A

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	B	C	A	A	D	C	B	D	A	C

• *Pyetjet me zhvillim*

**Pyetja 11**

**Model përgjigjeje**

- antikitetit – dalloheshin për numrin e madh të vendbanimeve qytetare
- mesjetës – dalloheshin ndërtimet në formën e kalave, kështjellave, qyteteve tregtare
- komunizmit – pallatet 4-5 katëshe (uniforme, standarde etj)

**3 pikë** nëse jep nga një karakteristikë për secilën nga periudhat

**OSE**

**2 pikë** nëse jep dy nga karakteristikat për dy nga periudhat

**1 pikë** nëse jep një nga karakteristikat për një nga periudhat

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Pyetja 12****Model përgjigjeje**

Elementët e valës detare janë:

- Kreshta e valës – pika më e lartë e valës
- Baza e valës - pika më e ulët e valës
- Lartësia e valës – largësia midis kreshtës dhe valës
- Gjatësia e valës – largësia midis dy kreshtave të njëpasnjëshme të valës.

**4 pikë** nëse shpjegon të katër elementet e valës detare

**OSE**

**3 pikë** nëse shpjegon tre nga elementet e valës detare

**2 pikë** nëse shpjegon dy nga elementet e valës detare

**1 pikë** nëse shpjegon një nga elementet e valës detare

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

---

**Pyetja 13****Model përgjigjeje**

- a) Përputhja e brigjeve lindorë të Amerikës së Jugut me brigjet perëndimorë të Afrikës
- b) Shpërndarja gjeografike e organizmave të sotëm dhe disa organizmave fosile
- c) Ngjashmëria mes shkëmbinjve në rajone shumë të largëta
- d) Ndryshimet klimatike

**3 pikë** nëse shkruan tre nga provat e Alfred Vegener

**OSE**

**2 pikë** nëse shkruan dy nga provat e Alfred Vegener

**1 pikë** nëse shkruan një nga provat e Alfred Vegener

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

---

**Pyetja 14****Model përgjigjeje**

- a) Rajoni përfshin gadishullin e Skandinavisë, Jutlandës dhe ishullin e Islandës.
- b) Rajoni dallohet për fjordet, vullkanet e gejzerët (Islandë)
- c) Dallohet për klimë të ftohtë
- d) Lumenjtë janë të shkurtër dhe me ujë të bollshëm
- e) Dallohet për liqene të shumtë akullnajorë etj.

**3 pikë** nëse shkruan tre nga veçoritë fiziko – gjeografike të Evropës Veriore

**OSE**

**2 pikë** nëse shkruan dy nga veçoritë fiziko – gjeografike të Evropës Veriore

**1 pikë** nëse shkruan një nga veçoritë fiziko – gjeografike të Evropës Veriore

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

---

**Pyetja 15****Model përgjigjeje**

- Ndryshe quhet si nënkontinenti indian.
- Ndodhen malet Himalaje me lartësi mbi 8500m
- Pellgjet lumore të Indit dhe Gangut kanë formuar fushën e Indo-Gangut
- Më në jug shtrihet pllaja e Dekanit, me origjinë tektonike
- Pllaja e Dekanit kufizohet në lindje dhe perëndim nga dy vargmale: Gatet Lindore dhe Gatet Perëndimore.
- Midis Pakistanit dhe Indisë gjendet shkretëtira Tar etj.

**3 pikë** nëse shkruan tre nga veçoritë fiziko – gjeografike të Azisë Jugore

**OSE**

**2 pikë** nëse shkruan dy nga veçoritë fiziko – gjeografike të Azisë Jugore

**1 pikë** nëse shkruan një nga veçoritë fiziko – gjeografike të Azisë Jugore

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

**Pyetja 16**


**3 pikë** nëse ndërton profilin e saktë

**OSE**

**2 pikë** nëse ndërton pingulet (projeksionet) dhe kodrën e parë

**1 pikë** nëse ndërton profilin e kodrës së parë **OSE** ndërton vetëm pingulet (projeksionet)

**0 pikë** Nëse e ndërton profilin gabim ose nuk e ndërton fare

**Pyetja 17****Model përgjigjeje**

- Industria nuk ishte më sektor primar i zhvillimit ekonomik
- Industria e rendë thuhetse pushoi se ekzistuari ajo u fokusua tek industria e lehte dhe ushqimore
- Sektor primar i zhvillimit ekonomik u bë bujqësia, duke u ndjekur nga ndërtimtaria, transporti, shërbimet etj.
- Rritje e bilancit negativ në tregtinë e jashtme si pasojë e rritjes së sasisë së importeve
- U bë kalimi nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut

**3 pikë** nëse analizon tre nga veçoritë e zhvillimit ekonomik në R.SH pas viteve '90 të shek. XX.

**OSE**

**2 pikë** nëse analizon dy nga veçoritë e zhvillimit ekonomik

**1 pikë** nëse analizon një nga veçoritë e zhvillimit ekonomik

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

**Pyetja 18****Model përgjigjeje**

Trendi i fazës së pestë të popullsisë është rënia dramatike e lindshmërisë, e cila shoqërohet me plakje të popullsisë. Dy vende që gjenden në këtë fazë janë Anglia, Franca etj.

**2 pikë** nëse shkruan trendin e fazës së pestë të tranzicionit demografik dhe jep emrin e një shteti që ndodhet në këtë fazë

**OSE**

**1 pikë** nëse shkruan trendin e fazës së pestë të tranzicionit demografik

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

*Shënim:* Nëse nxënësi shkruan vetëm emrin e shtetit nuk do të marrë asnjë pikë.

**Pyetja 19****Model përgjigjeje**

Rritja e popullsisë është e lartë pasi karakterizohet nga lindshmëri e lartë

Mosha mesatare është e vogël

Grupmosha e tretë zë një peshë specifike të vogël

Kjo piramidë moshore është karakteristikë e vendeve të varfra dhe atyre në zhvillim

**4 pikë** nëse jep një përgjigje të plotë si më sipër

**OSE**

**3 pikë** nëse jep tre nga përgjigjet e mësipërme

**2 pikë** nëse jep dy nga përgjigjet e mësipërme

**1 pikë** nëse jep një nga përgjigjet e mësipërme

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

**Pyetja 20****Model përgjigjeje**

Po ka lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm. Zhvillimi i qëndrueshëm është një zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes, pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre. Pra ne kemi detyrimi moral ta mbrojmë planetin tone dhe t'ua lemë pasardhësve tanë në gjendje më të mirë.

**2 pikë** nëse bën një argumentim **të plotë** në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm

**OSE**

**1 pikë** Nëse bën argumentim **të pjesshëm** në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare